



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 2.7.2019

Dokument parlamentar

R A P O R T

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR
2018 PËR PROJEKTIN “PROGRAMI SEKTORIAL I UJËRAVE/FURNIZIMI ME UJË
I ZONAVE RURALE IV””**

• ***Hyrje.***

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 2 korrik 2019, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2018 për projektin “Programi sektorial i ujërave/furnizimi me ujë i zonave rurale IV””.

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj në përputhje me procedurat e parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relatore për këtë projektligj znj. Evis Kushi.

Në mbledhje ishin të pranishëm, për të paraqitur projektligjin dhe për të dhënë informacionet e kërkuara nga deputetët, Zëvendësministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Ujësjetillës-Kanalizimeve dhe të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

- **Baza kushtetuese e projektligjit.**

Këshilli i Ministrave e paraqiti projektligjin bazuar në nenet 81, pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, si dhe në nenin 17 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 të Rregullores së Kuvendit.

- **Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit.**

Marrëveshja, që propozohet të ratifikohet me këtë projektligj, synon sigurimin e financimit të nevojshëm për realizimin e fazës së katërt të projektit “Furnizimi me ujë i zonave rurale”. Ky projekt mbështetet në prioritetet e përcaktuara në dokumentet strategjike të vendit, siç janë Strategjia Kombëtare për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet, si dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integritet 2015-2020. Në zbatim të këtyre dokumenteve, sektori i turizmit po arrin përmirësime të ndjeshme sasiore e cilësore vitet e fundit. Faza e katërt e këtij projekti është vazhdim i rezultateve pozitive të arritura gjatë fazave të mëparshme, përmes të cilave u arrit të përmirësohej furnizimi me ujë në më shumë se 160 fshatra të vendit.

Gjatë fazës së katërt, projekti parashikon kryerjen e investimeve në zonën bregdetare në jug të vendit, duke u fokusuar në Bashkitë e Himarës dhe Orikumit, të cilat janë zonat më të rëndësishme turistike dhe kanë potencial për zhvillim të mëtejshëm. Këto investime do të destinohen për përmirësimin e infrastrukturës së ujësjellësve dhe kanalizimeve e konkretisht, për përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm, si dhe përmirësimin e sistemit të kanalizimeve, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

Marrëveshja parashikon që Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë të marrë nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, nëpërmjet bankës KFW, një kredi të butë me vlerë të përgjithshme deri në 40 milionë euro për realizimin e projektit, si dhe një grant prej 2 milionë eurosh për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit.

Kjo marrëveshje është marrëveshje kuadër dhe do të pasohet nga marrëveshjet e financimit që do të lidhen midis KFW-së dhe marrësve të shumave të financimit. Agjencia zbatuese e projektit është Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Këshilli i Ministrave është në rolin e garatuesit të kredisë. Financimi për këtë projekt është parashikuar në programin buxhetor afatmesëm 2019-2021 të FZSH-së, në programin “Furnizimi me ujë i zonave rurale IV”.

Marrëveshja pritet të ndikojë në përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe kushteve të jetesës së qytetarëve. Ajo do të sjellë zhvillimin e mëtejshëm të turizmit dhe rritjen e numrit të përfituesve. Kjo marrëveshje është shprehje e kontributit të rëndësishëm që ka dhënë e vijon të japë qeveria Gjermane për ekonominë e vendit tonë, por edhe e rritjes së aftësisë kredimarrëse të vendit tonë. Kredia do të merret me kushte të buta, ndaj edhe kostoja e saj është e ulët.

- ***Diskutimi në Komision.***

Relatorja paraqiti vlerësimin e saj për projektligjin, duke vënë theksin në rolin që ai do të luajë në përmirësimin e infrastrukturës së ujësjellës-kanalizimeve në zonat kryesore turistike jugore të vendit dhe zhvillimin e turizmit në vendin tonë.

Zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë paraqiti projektligjin, duke u ndalur në detaje mbi projektin, ecurinë e projekteve të mëparshme dhe atyre të parashikuara të vijojnë në të ardhmen në fushën e infrastrukturës së ujësjellës-kanalizimeve në zonat rurale të vendit. Gjithashtu, ai dha sqarimet e nevojshme për pyetjet e deputetëve.

Gjatë diskutimit anëtarët e Komisionit e vlerësuan projektligjin shumë të rëndësishëm për zgjidhjen e problematikave ekzistuese në fushën e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, i cili do të sjellë përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve dhe turistëve në zonat më të rëndësishme turistike të vendit.

- ***Përfundim.***

Mbështetur në argumentet e mësipërme, Komisioni e miratoi projektligjin me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm në mbledhje.

RELATORE

Evis KUSHI

KRYETARI

Arben AHMETAJ